



DEKLARATE E VULLNETARIT

Ju lutemi lexojeni dhe firmoani këtë formular, nëse ju KENI jetuar 10 vitet e fundit në Shtetin e Pensilvanisë.

Kërkesë e Ligjit të Shërbimit për Mbrojtjen e Fëmijës 23 Pa.C.S. §6344.2 (Në lidhje me vullnetarët, që kanë kontakt me fëmijët)

Unë betohem/dekloroj, që jam duke kërkuar një pozicion si vullnetar dhe NUK JAM duke kërkuar që të marr një certifikatë nga Byroja Federale e Hetimit (FBI), për arsye se:

- Pozicioni për të cilin po aplikoj është pa pagesë; dhe
- Unë kam qënë rezident në Pensilvani, pa ndërprerje gjatë dhjetë viteve të fundit.

Unë betohem/dekloroj, që nuk kam qënë i cilësuar si fajtor në një raport të bazuar për abuzim me fëmijë, brenda pesë (5) viteve të fundit, siç edhe përcaktohet nga Ligji i Shërbimeve Mbrojtëse për Fëmijën.

Unë betohem/dekloroj, që nuk kam qënë i dënuar në ndonjë prej krimeve të mëposhtëme sipas "Title 18 of the Pennsylvania Consolidated Statutes" ose vepra të ngjashme në natyrë me këto krime, sipas ligjeve, ose ligjeve të mëparshme të Shteteve të Bashkuara, ose prej ndonjë nga territoret dhe posedimet e saj, të një shteti tjetër, Distrikti i Kolumbias, Komonuelthi i Porto Rikos ose një shtet i huaj, ose sipas një ligji të mëparshëm të Komonuelthit.

Kapitulli 25	(lidhet me vrasje kriminale)
Seksioni 2702	(lidhet me sulm të rëndë)
Seksioni 2709	(lidhet me kërcënimin)
Seksioni 2901	(lidhet me rrëmbimin)
Seksioni 2902	(lidhet me kufizim të paligjshëm)
Seksioni 3121	(lidhet me përdhunimin)
Seksioni 3122.1	(lidhet me sulm të cilësuar seksual)
Seksioni 3123	(lidhet me devijimin e pavullnetshëm të marrdhënieve seksuale)
Seksioni 3124.1	(lidhet me sulmin seksual)
Seksioni 3125	(lidhet me sulm të turpshëm të rëndë)
Seksioni 3126	(lidhet me sulm të turpshëm)
Seksioni 3127	(lidhet me ekspozimin e pahijshëm)
Seksioni 4302	(lidhet me incestin)
Seksioni 4303	(lidhet me fshehjen e vdekjes së fëmijës)
Seksioni 4304	(lidhet me rrezikimin e mirëqenies së fëmijëve)
Seksioni 4305	(lidhet me fëmijët e vegjël)
Seksioni 5902(b)	(lidhet me prostitucionin dhe vepra penale që lidhen me të)
Seksioni 5903(c) (d)	(lidhet me shfaqje të pahijshme dhe materiale të tjera seksuale)
Seksioni 6301	(lidhet me korrupsionin e të miturve)
Seksioni 6312	(lidhet me abuzimin seksual të fëmijëve), ose një krim të njëjtë sipas Ligjit Federal, ose të ndonjë shteti tjetër.

Unë nuk kam qenë i dënuar për një veprë penale sipas Act 64-1972 (lidhur me substancat e kontrolluara, paisje të drogës dhe aktit kozmetik) të kryer brenda pesë viteve të fundit.

Unë e kuptoj që nuk do të miratohem për shërbim, nëse unë jam cilësuar si fajtor në një raport të bazuar për abuzim me fëmijë, brenda pesë (5) viteve të fundit, ose kam qenë i dënuar për ndonjë nga krimet e listuara më lart, ose vepra të ngjashme në natyrë me këto krime, sipas ligjeve, ose ligjeve të mëparshme të Shteteve të Bashkuara, ose prej ndonjë nga territoret dhe posedimet e saj, të një shteti tjetër, Distrikti i Kolumbias, Komonuelthi i Porto Rikos ose një shtet i huaj, ose sipas një ligji të mëparshëm të Komonuelthit.

Unë e kuptoj që, nëse jam arrestuar, ose dënuar për një veprë penale, e cila do të përbënte bazën për mohimin e pjesëmarrjes në një program, aktivitet, ose shërbim sipas Ligjit të Shërbimeve Mbrojtëse të Fëmijës, sipas listimit të mësipërm, ose jam përmendur si fajtor në një raport të bazuar, ose që ngre dyshime, Unë duhet t'i ofroj administratorit, ose të caktuarit prej tij një njoftim me shkrim jo më vonë se 72 orë pas arrestimit, dënimit, ose njoftim që Unë kam qenë i listuar si fajtor në databazën e Shtetit.

Unë e kuptoj që nëse personi përgjegjës për punësimin, ose administratori i programit, aktivitetit, ose shërbimit, ka një bindje të arsyeshme, që unë kam qenë i arrestuar, ose i dënuar për një krim, që mund të shërbejë si bazë për mohimin e pjesëmarrjes në një program, aktivitet, ose shërbim, sipas Ligjit të Shërbimeve Mbrojtëse të Fëmijës, ose jam përmendur si fajtor në një raport të bazuar, ose që ngre dyshime, ose unë kam dhënë njoftim sipas kërkesave të këtij seksioni, personi përgjegjës për punësimin, ose administratori i programit, aktivitetit, ose shërbimit duhet që menjëherë të më kërkojë që të paraqes sipas nevojës, çertifikatat e pastërtisë të marra nëpërmjet Departamentit të Shërbimeve Njerëzore, Policisë të Shtetit të Pensilvanisë, Byrosë Federale të Hetimit. Kostoja e çertifikatave do të përballohet programi, ose njësia e punësimit, aktiviteti, ose shërbimi.

Unë e kuptoj që nëse me dashje nuk jap të gjithë informacionin e kërkuar si më sipër, Unë kryej një kundërvajtje të gradës së tretë dhe do të jem subjekt për masë disiplinore deri në përjashtimin nga pozicioni i vullnetarit. Unë e kuptoj që personi përgjegjës për punësimin, ose administratori i programit, aktivitetit, ose shërbimit do të mbajë në ruajtje një kopje të çertifikatave të mia.

Me anë të kësaj, Unë betohem/deklaroj, që informacioni i deklaruar prej meje është i vërtetë dhe i saktë. Unë e kuptoj, që betimi i rremë është kundërvajtje në pajtim me Seksionin 4063 të Kodit të Krimeve ("Section 4903 of the Crimes Code").

Emri: _____ Firma: _____

Data: _____